

Prot. 12140

dt 02.10.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

V E N D I M

Nr. 602, datë 02 . 10 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONAT E DËMTUARA PIKËSORE, PËR 257 BANESA INDIVIDUALE , BASHKIA DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimve të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr. 39, datë 22.07.2020 dhe Nr. 37, datë 17.07.2020,

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 257 banesa Individuale, Bashkia Durrës, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
  - b) Materiali hartografik:
    - i. Harta e Përdorimit të Tokës dhe Projektimit Urban;
    - ii. Harta e Infrastrukturave dhe Mbrojtjes së Tokës;
  - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.
2. Miratohet rindërtimi në Zonat e dëmtuara pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, me qëllin rindërtimin e objekteve të cilat referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 257 banesa Individuale, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 257 banesa Individuale të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETARI**

**EMIRIANA SAKO**

